



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 61

Tiranë – E martë, 11 prill 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 203, datë 7.4.2023	Për procedurat e zbatimit dhe fillimin e aplikimit të regjimit të veçantë për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike..... 6777
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 2, datë 31.3.2023	Për caktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përmbauesit gjqësor privat, për kryerjen e njoftimit të akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare..... 6778
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 3, datë 31.3.2023	Për caktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përmbauesit gjqësor privat për shitjen e sendeve në ankand publik 6779
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 4, datë 31.3.2023	Për caktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përmbauesit gjqësor privat për kryerjen e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi..... 6781
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 5, datë 31.3.2023	Për caktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përmbauesit gjqësor privat për kryerjen e njoftimit apo mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim 6785
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 10, datë 31.3.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 14, datë 27.5.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”..... 6786
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 241, datë 31.3.2023	Për miratimin e modelit të kontratës që lidhet midis përmbauesit gjqësor privat dhe palës së interesuar për shitjen e sendeve në ankand publik..... 6788
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 242, datë 31.3.2023	Për miratimin e modelit të kontratës që lidhet midis përmbauesit gjqësor privat dhe palës së interesuar për njoftimin dhe mbledhjen e detyrimeve financiare me mirëkuptim..... 6793

**VENDIM****Nr. 203, datë 7.4.2023****PËR PROCEDURAT E ZBATIMIT DHE
FILLIMIN E APLIKIMIT TË REGJIMIT
TË VEÇANTË PËR BURSËN SHQIPTARE
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 155/3, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Objekt i këtij vendimi është parashikimi i procedurave të zbatimit dhe fillimit të aplikimit të regjimit të veçantë për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

2. Tregtimi i energjisë elektrike në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike kryhet në përputhje me modelin e tregut të energjisë elektrike dhe rregullat e tregtimit, miratuar me vendimin nr. 347, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike”.

3. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, në rolin e saj si kundërpalë qendrore, vendoset ndërmjet transaksioneve të palëve brenda tregut të energjisë elektrike dhe merr rolin e blerësit kundrejt kundërpalës shitëse dhe rolin e shitësit kundrejt kundërpalës blerëse me qëllim garantimin e transaksioneve.

4. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike, sipas modelit të tregtimit të energjisë elektrike, nuk kryen në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimtari të shitblerjes së energjisë elektrike, por ofron shërbimin e administrimit e të garantimit të kësaj veprimtarie, nëpërmjet platformës së tregtimit, klerimit dhe shlyerjes, si kundërpalë qendrore. Duke pasur këtë rol për të gjitha transaksionet që kryhen në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, si në blerje ashtu edhe në shitje të energjisë elektrike, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ka edhe përgjegjësinë e lëshimit të faturës, si për blerësin ashtu edhe për shitësin e energjisë elektrike.

5. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike përgatit një faturë tatimore për kundërpalën blerëse dhe një faturë tatimore për kundërpalën shitëse, të cilat

rezultojnë fitues nga urdhërporositë e vendosura në platformën e tregut dhe në transaksione të përmbyllura, si më poshtë vijon:

a) Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike lëshon një faturë tatimore për anëtarin e saj që nga transaksionet e përmbyllura gëzon pozicionin e blerësit të energjisë elektrike, e cila do të jetë me TVSH të përjashtuar.

b) Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike lëshon një faturë tatimore, në emër të anëtarit të saj, i cili nga transaksionet e përmbyllura gëzon pozicionin e shitësit të energjisë elektrike. Kjo faturë do të jetë me TVSH të përjashtuar, duke zbatuar përcaktimet e nenit 100, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

6. Mënyra e faturimit dhe qëllimet e përdorimit të energjisë elektrike të blerë nga anëtari fitues në pozicionin e blerësit të energjisë elektrike nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike kryhen, si më poshtë vijon:

a) Në rastin kur blerësi i energjisë elektrike e përdor atë për nevojat e veta, duke mos pasur si qëllim që ta rishesë, ai përgatit një faturë tatimore, në të cilën është edhe në pozicionin e shitësit edhe në pozicionin e blerësit. Ky furnizim do t'i nënshtrohet normës standarde 20% të TVSH-së.

b) Në rastin kur blerësi i energjisë elektrike ia furnizon energjinë elektrike një personi të tatueshëm brenda vendit, faturimi kryhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit. Ky furnizim do t'i nënshtrohet normës standarde 20% të TVSH-së.

c) Në rastin kur blerësi i energjisë elektrike ia furnizon energjinë elektrike një personi të tatueshëm jashtë Republikës së Shqipërisë, faturimi kryhet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në legjislacionin në fuqi për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit. Ky furnizim eksporti do të trajtohet me shkallë 0% të TVSH-së.

7. Aplikimi i regjimit të veçantë për Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike fillon me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Bursa



Shqiptare e Energjisë Elektrike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 2, datë 31.3.2023

**PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË
VEPRIMTARISË DYTËSORE TË
PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT,
PËR KRYERJEN E NJOFTIMIT TË
AKTEVE GJYQËSORE DHE
DOKUMENTEVE ZYRTARE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të neni 36, pika 2, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”,

UDHËZOJ:

I. Objekti i udhëzimit

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i tarifave për kryerjen e njoftimit të akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare nga përmbaruesit gjyqësorë privatë, me kërkesë të të interesuarve ose me autorizim të gjykatës, si dhe mënyrës së pagesës së tyre.

II. Fusha e zbatimit të udhëzimit

Ky udhëzim zbatohet, në rastet e:

a) kryerjes së njoftimit të akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare, me kërkesë të gjykatës;

b) kryerjes së njoftimit të dokumenteve zyrtare, me kërkesë të personave fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë.

III. Tarifa e shërbimit të njoftimit të dokumenteve zyrtare

1. Tarifa e njoftimit të dokumenteve zyrtare është pagesa që kryhet nga i interesuari për të mundësuar ofrimin e shërbimit të përmbaruesit gjyqësor privat për njoftimin e tyre.

2. Për kryerjen e njoftimit të dokumenteve zyrtare, me kërkesë të personave fizikë dhe juridikë privatë, vlera e tarifës përllogaritet, si më poshtë:

a) kur nuk kryhet njoftimi në adresën e deklaruar dhe adresa e deklaruar është e saktë, tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë;

b) kur nuk kryhet njoftimi në adresën e deklaruar dhe adresa e deklaruar është e pasaktë, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej mbledhjes së vlerës prej 7 000 (shtatë mijë) lekësh dhe vlerës së tarifës për konstatimin e adresës, të parashikuar në udhëzimin në fuqi të ministrit të Drejtësisë;

c) kur njoftimi kryhet në adresën e deklaruar në një qytet tjetër, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej vlerës 10 000 (dhjetë mijë) lekësh dhe vlerës së parapaguar të shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit;

ç) kur njoftimi kryhet në adresën e padeklaruar në një qytet tjetër, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej mbledhjes së vlerës së gjysmës së pagës minimale në shkallë vendi, vlerës së parapaguar të shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit, si dhe tarifës për konstatimin e adresës, të parashikuar në udhëzimin e ministrit të Drejtësisë.

3. Për kryerjen e njoftimit të dokumenteve zyrtare, me kërkesë të personave juridikë publikë, vlera e tarifës përllogaritet, si më poshtë:

a) kur nuk kryhet komunikimi në adresën e deklaruar dhe adresa e deklaruar është e saktë, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej mbledhjes së vlerës së gjysmës së pagës minimale në shkallë vendi dhe vlerës së parapaguar të shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit;

b) kur nuk kryhet komunikimi në adresën e deklaruar dhe adresa e deklaruar është e pasaktë, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej mbledhjes së vlerës së një page minimale në shkallë vendi dhe tarifës për konstatimin e adresës, të parashikuar në udhëzimin në fuqi të ministrit të Drejtësisë;

c) kur njoftimi kryhet në një njësi administrative tjetër të një qarku tjetër, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej mbledhjes së vlerës së tarifës të përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike dhe vlerës së parapaguar të shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit.

4. Për kryerjen e njoftimit të akteve gjyqësore, vlera e tarifës përllogaritet, si më poshtë:

a) kur nuk kryhet njoftimi në adresën e deklaruar dhe adresa e deklaruar është e saktë, tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë;



b) kur nuk kryhet komunikimi në adresën e deklaruar dhe adresa e deklaruar është e pasaktë, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej mbledhjes së vlerës prej 7 000 (shtatë mijë) lekësh dhe tarifës për konstatimin e adresës, të parashikuar në udhëzimin në fuqi të ministrit të Drejtësisë;

c) në një njësi administrative tjetër/të ndryshme të një qarku tjetër, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej mbledhjes së vlerës së tarifës të përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike dhe vlerës së parapaguar të shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit.

5. Për efekt të llogaritjes së tarifës të përcaktuar në pikat 2 deri 4 të këtij kreu, vlera e shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit nuk mund të jetë më e ulët se:

a) 9 000 (nëntë mijë) lekë, për distancën që varion nga 50 km deri në 100 km;

b) 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë, për distancën që varion nga 100 km deri në 150 km;

c) 20 000 (njëzet mijë) lekë, për distancën që varion nga 150 km deri në 200 km;

ç) 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë, për distancën që varion nga 200 km deri në 300 km;

d) masa e një page minimale në shkallë vendi, për distanca mbi 300 km.

IV. Mënyra e pagimit të tarifës së shërbimit të njoftimit të dokumenteve zyrtare dhe/ose akteve

1. Tarifa e përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të kreut III të këtij udhëzimi paguhet nga personi fizik ose juridik, publik ose privat, nëpërmjet sistemit bankar, në llogarinë e përmbaruesit gjyqësor privat për administrimin e aktivitetit tregtar si person fizik ose juridik.

2. Tarifa e përcaktuar në pikën 4 të kreut III të këtij udhëzimi paguhet nga pala së cilës i janë ngarkuar shpenzimet nga gjykata, në llogarinë e përmbaruesit gjyqësor privat për administrimin e aktivitetit tregtar si person fizik ose juridik.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

UDHËZIM

Nr. 3, datë 31.3.2023

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË VEPRIMTARISË DYTËSORE TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT PËR SHITJEN E SENDEVE NË ANKAND PUBLIK

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 36, pika 2, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”,

UDHËZOJ:

I. Objekti

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i tarifave për kryerjen e shitjes së sendeve në ankand publik, me kërkesë të të interesuarve, nga përmbaruesit gjyqësorë privatë dhe i mënyrës së pagesës së tyre, kur ankandi zhvillohet në kuadër të veprimtarisë dytësore të përmbaruesit gjyqësor privat.

II. Fusha e zbatimit të udhëzimit

1. Ky udhëzim zbatohet vetëm në rastet e kryerjes së shitjes së sendeve në ankand publik si veprimtari dytësore e përmbaruesit gjyqësor privat, bazuar në kërkesën e personave fizikë dhe juridikë *privatë*, për shitjen në ankand të sendeve të cilat janë në pronësi të tyre.

2. Në rastin e sendeve të luajtshme të përdorimit të zakonshëm dhe që nuk kanë veçanërisht vlerë muzeale, numizmatike, koleksioni, artistike, pronësia e të cilave nuk mund të vërtetohet ndryshe, përmbaruesi gjyqësor privat pranon vetëdeklarimin për pronësinë e palës së interesuar mbi sendin, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij.

3. Ky udhëzim zbatohet edhe për procedurën e ankandit të sendeve, kur ato i nënshtrohen shitjes, sipas marrëveshjes së palëve për mbledhjen e detyrimeve financiare me mirëkuptim, si veprimtari dytësore e përmbaruesit gjyqësor privat.

III. Llojet e sendeve që i nënshtrohen tarifave të shërbimit për zhvillimin e ankandit

1. Ky udhëzim zbatohet për sendet e mëposhtme:



a) sendet e çmueshme në pronësi të të interesuarit;

b) sendet e paluajtshme në pronësi të të interesuarit ose në bashkëpronësi të tij;

c) sendet e luajtshme në pronësi të të interesuarit, që nuk përjashtohen nga qarkullimi civil.

IV. Tarifa për kryerjen e shitjes së sendit në ankand publik

1. Shërbimi i shitjes së sendeve në ankand ofrohet nga përmbartuesi gjyqësor privat kundrejt pagesës së tarifave të përcaktuara në pikën 2 të këtij kreu.

2. Tarifa për kryerjen e shitjes së sendit në ankand publik përbëhet nga:

a) tarifa e aplikimit në shumën 5 000 (pesë mijë) lekë;

b) tarifa e zhvillimit të procedurës së ankandit, që mbulon publikimin e kërkesës në faqen elektronike të zhvillimit të ankandeve, kostot dhe shërbimin e përmbartuesit në shumën e 3 (tri) pagave minimale mujore;

c) tarifa mbi vlerën e shitjes së sendit në ankand, që përcaktohet në varësi të sendit, si më poshtë:

i. për sendet e paluajtshme në pronësi të të interesuarit, në masën e 3% (tre për qind) të vlerës së shitjes së sendit;

ii. për sendet e çmueshme në pronësi të të interesuarit, në masën 10% (dhjetë për qind) të vlerës së shitjes së sendit;

iii. për sendet e luajtshme në pronësi të të interesuarit, që nuk përjashtohen nga qarkullimi civil, në masën e 5% (pesë për qind) të vlerës së shitjes së sendit.

3. Vlerës së tarifës së shërbimit, sipas pikës 2 të këtij kreu, në momentin e faturimit i shtohet TVSH-ja, sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

V. Mënyra e pagimit të tarifës së shërbimit

1. Tarifat e përcaktuara në kreun IV të këtij udhëzimi paguhet nga pala e interesuar nëpërmjet sistemit bankar, në llogarinë e përmbartuesit gjyqësor privat për administrimin e aktivitetit tregtar si person fizik ose juridik.

2. Tarifa e shërbimit për aplikimin për shitjen e sendit në ankand paguhet nga i interesuari, pasi përmbartuesi gjyqësor privat ka pranuar lirisht kërkesën për shitjen e sendit në ankand publik.

3. Tarifa e shërbimit për aplikimin është e pakthyeshme, me përjashtim të rasteve kur vërtetohet nga i interesuari se publikimi i kërkesës

në faqen elektronike të zhvillimit të ankandeve nuk është kryer.

4. Tarifa e zhvillimit të procedurës së ankandit është e pakthyeshme, pavarësisht rezultatit të procedurës së shitjes së sendit, në seancën e ankandit të zhvilluar për këtë qëllim. Seanca e ankandit përsëritet jo më shumë se dy herë për të njëjtin send, sipas marrëveshjes së parashikuar në kontratën tip që lidhet ndërmjet përmbartuesit gjyqësor privat me palën e interesuar, miratuar me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

5. Përmbartuesi gjyqësor privat transferon çmimin e sendit të shitur në ankand, sipas rastit, brenda 3 (tri) ditëve nga përfundimi i seancës së ankandit, në llogarinë e të interesuarit për pasuritë e luajtshme ose brenda 3 ditëve pas kalimit të pasurisë në emër të blerësit për rastin e sendeve të paluajtshme ose sendeve të luajtshme që regjistrohen në regjistrin publik. Për pagimin e tarifës mbi vlerën e shitjes së sendit, përmbartuesi gjyqësor privat mban në llogarinë e tij për administrimin e aktivitetit tregtar, si person fizik ose juridik, vlerën e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 2, të kreut IV të këtij udhëzimi, përpara se të transferojë vlerën e çmimit të sendit të shitur në llogarinë e të interesuarit.

6. Përmbartuesi gjyqësor privat, pasi konstaton derdhjen e vlerës së sendit të shitur në ankand në llogarinë e të interesuarit, brenda 3 (tri) ditëve nxjerr vendimin për kalimin në pronësi të fituesit të sendit të blerë në ankandin publik, organizuar nga përmbartuesi gjyqësor privat dhe e depoziton në zyrën vendore kadastrale.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

SHTOJCA NR. 1
MODELI I VETËDEKLARIMIT

VETËDEKLARIM

**Për pronësinë e sendit që do t'i nënshtrohet
shitjes në ankand publik,
nga përmbartuesi gjyqësor privat**

Unë i/e nënshkruari/a _____



(për individin jepen: emri, atësia, mbiemri, numri i dokumentit të identifikimit adresa, adresa elektronike, nr. llogarie bankare, nr. tel./fax /cel.; ndërsa për personin fizik/juridik privat jepen: emri, NUIS, adresa elektronike, nr. i llogarisë bankare; selia, si dhe emri, atësia, mbiemri dhe numri i dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor), sipas përcaktimeve të pikës 2 të kreut II të udhëzimit të ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e tarifave për veprimtarinë dytësore të përmbauesit gjyqësor privat për shitjen e sendeve në ankand publik”, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë marrjen dijeni për ngarkimin me përgjegjësi penale për kryerjen e një deklarimi të rremë, sipas parashikimeve të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, se jam pronar i sendit

(përshterubën në mënyrë të detajuar të dhënat identifikuese të sendit dhe sipas rastit, dokumente provuese), që do të shitet në ankand publik nga përmbauesi gjyqësor privat _____ (emri i përmbauesit gjyqësor privat), me nr. licence _____, NUIS _____, adresë postare _____).

Nëpërmjet këtij vetëdeklarimi deklaroj, se:

1. I gjithë informacioni që i kam vënë në dispozicion përmbauesit gjyqësor privat është i vërtetë dhe i saktë.

2. Jam i informuar se përbën shkelje në kuptim të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë:

a) dhënia e një informacioni/deklarimi të pasaktë/të pavërtetë;

b) paraqitja e dokumenteve të falsifikuara.

3. Deklaroj dhe pranoj se, nëse vërtetohet pasaktësia/falsiteti i një informacioni dhe/ose një dokumenti, ndaj meje mund të ndërmerren masat e nevojshme të përgjegjësisë civile dhe penale, për shkak të pasaktësisë/pavërtetësisë apo falsitetit të provuar.

4. Deklaroj dhe pranoj se të gjitha të dhënat e vëna në dispozicion nga unë, mund të verifikohen për efekt të saktësisë dhe vërtetësisë së tyre lidhur me aplikimin tim dhe se ky deklarim shërben si autorizim për përmbauesin gjyqësor privat për të ndërmarrë çdo veprim, me qëllim verifikimin e të dhënave të këtij vetëdeklarimi, për qëllime të shitjes së sendit në ankand.

5. Deklaroj dhe pranoj se në vijim do të informoj mbi çdo informacion shtesë që do të

ndryshojë statusin tim si pronar i sendit objekt shitje në ankand publik nga përmbauesi gjyqësor privat.

VETËDEKLARUESI/PALA E INTERESUAR

Emri

Mbiemri _____

Nënshkrimi _____

Data ____ . ____ . ____

UDHËZIM

Nr. 4, datë 31.3.2023

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË VEPRIMTARISË DYTËSORE TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT PËR KRYERJEN E KONSTATIMEVE TË FAKTEVE, SENDEVE DHE DUKURIVE LEHTËSISHT TË VERIFIKUESHME, QË NUK KËRKOJNË NJOHURI SPECIFIKE TEKNIKE, SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 36, pika 2, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”,

UDHËZOJ:

I. Objekti i udhëzimit

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i tarifave për kryerjen e konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike sipas legjislacionit në fuqi, me kërkesë të të interesuarve dhe i mënyrës së pagesës së tyre.

II. Fusha e zbatimit të udhëzimit

1. Ky udhëzim zbatohet vetëm në rastet e kryerjes së konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi, bazuar në kërkesën e personave të interesuar fizikë dhe juridikë privatë.

2. Ofrimi i shërbimit që lidhet me veprimtarinë e konstatimit të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme nga përmbauesi gjyqësor privat, kryhet gjithnjë duke plotësuar nevojat e ligjshme të të interesuarve gjatë ushtrimit



të funksionit të përmbaruesit gjyqësor privat, si dhe duke u kujdesur për respektimin e detyrimit profesional të konfidencialitetit dhe ruajtjen e privatësisë së personave apo pasurive, gjatë fiksimit, përpilimit dhe ruajtjes së provave që dëshmojnë fakte juridike, me qëllim konstatimin e tyre, përfshirë përdorimin e mjeteve teknologjike për këtë qëllim.

III. Konstatimet për të cilat aplikohet tarifa

1. Përmbaruesi gjyqësor privat kryen konstatimin e fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi, nëpërmjet fotografive, filmimeve ose mjeteve të tjera teknologjike, sipas rastit kur e kërkon natyra dhe lloji i konstatimit. Gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie, përmbaruesi gjyqësor privat mban procesverbalin e konstatimit, sipas shtojcës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij.

2. Pala e interesuar paguan tarifën për ofrimin e shërbimit të konstatimit të fakteve, sendeve dhe dukurive, të listuara, si më poshtë:

a) konstatimi i fakteve, të cilat pasqyrojnë dëmet e ardhura, si pasojë e tërmete, zjarreve apo përmbytjeve në pasurinë e palës së interesuar;

b) konstatimi i fakteve që lidhen me përdorimin e emrit të palës së interesuar nga një person tjetër;

c) konstatimi i adresës, vendbanimit ose vendqëndrimit të palës së interesuar;

ç) konstatime në lidhje me posedimin dhe/ose përdorimin e sendit nga pala e interesuar;

d) konstatime në lidhje me cenimin ose dëmtimin e pasurisë të palës së interesuar;

dh) konstatime në lidhje me kufijtë ndarës të pasurive të paluajtshme, ku të paktën njëra prej pasurive të jetë në pronësinë e palës së interesuar;

e) konstatime në lidhje me të metat e sendit në pronësi ose posedim të palës së interesuar;

ë) konstatime në lidhje me respektimin e së drejtës së ekskluzivitetit, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

f) konstatime në lidhje me publikime të pavërteta ndaj palës së interesuar;

g) konstatime të dorëzimit të pasurisë së paluajtshme, në bazë të kontratës së porosisë, sipër-marrjes apo shitjes, kur njëra nga palët kontraktore është pala e interesuar;

gj) konstatime të mospërmbushjes së detyrimit të takimit të fëmijës me prindin të cilit nuk i është lënë për rritje dhe edukim sipas vendimit gjyqësor

të formës së prerë, kur pala e interesuar është prindi i fëmijës;

h) konstatime të vendeve dhe të mjeteve të personit të dëmtuar i cili është pala e interesuar, me qëllim mbrojtjen e të drejtave ndaj shoqërive të sigurimit, pa cenuar veprimtarinë e organeve ligjzbatuese;

i) konstatime në lidhje me respektimin e kushteve të sigurisë nga pala e dëmtuar, e cila është pala e interesuar ose trashëgimtarët e tyre;

j) konstatime në lidhje me dhunën e ushtruar ndaj palës së interesuar, pa cenuar integritetin gjinor;

k) konstatime në lidhje me cenimin e nderit, personalitetit ose reputacionit të palës së interesuar;

l) konstatime në lidhje me produktet që i ofrohet konsumatorit, i cili është pala e interesuar;

m) konstatime në internet dhe rrjete sociale që ndërveprojnë me njëra-tjetrën në platformat e internetit;

n) konstatime mbi pajisjet, aparatet elektronike të identifikuar në pronësi të punëdhënësit nga prodhuesi ose mjeteve të tjera teknologjike që ruhen ose lidhen me sistemin e informacionit profesional të punëdhënësit;

o) konstatime lidhur me ndotjet nga zhurmat dhe lloje të ndryshme të ndotjes, që **shkaktojnë vështirësi te pala e interesuar apo** cenon cilësinë e jetës së saj.

3. Konstatimet e fakteve, sipas pikës 2 të këtij kreu, të fiksuara nëpërmjet fotografive, filmimeve ose mjeteve të tjera teknologjike kryhen nëpërmjet aparateve elektronike të identifikuar nga prodhuesi, që figurojnë në çastin e kryerjes së veprimit konstatues të regjistruara dhe/ose në pronësi të përmbaruesit gjyqësor privat.

IV. Tarifa e shërbimit të kryerjes së konstatimeve të fakteve, sendeve dhe dukurive

1. Tarifa e shërbimit të konstatimit të fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi, është pagesa që kryhet nga pala e interesuar për të mundësuar marrjen e këtij shërbimi ligjor nga përmbaruesi gjyqësor privat.

2. Vlera e tarifës për konstatimet sipas pikës 2 të kreut III, përllogaritet si më poshtë:

a) për fakte të cilat pasqyrojnë dëmet e ardhura si pasojë e tërmete, zjarreve apo përmbytjeve në pasurinë e palës së interesuar, vlera e tarifës së shërbimit është në masën e 10 000 (dhjetë mijë) lekëve;



b) për konstatimin e fakteve që lidhen me përdorimin e emrit të palës së interesuar nga një person tjetër, vlera e tarifës së shërbimit është në masën e 5 000 (pesë mijë) lekëve;

c) për konstatimin e adresës, vendbanimit ose vendqëndrimit të palës së interesuar, vlera e tarifës së shërbimit është në masën e 5 000 (pesë mijë) lekëve;

ç) për konstatimet sipas shkronjave “ç”, “d”, “dh” dhe “e” të pikës 2 të kreut III, vlera e tarifës së shërbimit është në masën e pagës bazë minimale mujore;

d) për konstatimet në lidhje me cenimin e nderit, personalitetit ose reputacionit të palës së interesuar, vlera e tarifës së shërbimit është në masën e 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëve;

dh) për konstatimet e vendeve dhe të mjeteve të personit të dëmtuar me qëllim mbrojtjen e të drejtave ndaj shoqërive të sigurimit, vlera e tarifës së shërbimit është në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëve;

e) për konstatimet në lidhje me respektimin e kushteve të sigurisë, vlera e tarifës së shërbimit është në masën e 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëve;

ë) për konstatimet në lidhje me produktet që i ofrohet konsumatorit, vlera e tarifës është në masën e 10 000 (dhjetë mijë) lekëve;

f) për konstatime në lidhje me dhunën e ushtruar ndaj palës së interesuar, vlera e tarifës është në masën e 10 000 (dhjetë mijë) lekëve;

g) për konstatime në lidhje me respektimin e të drejtës së ekskluzivitetit, vlera e tarifës është në masën e 20 000 (njëzet mijë) lekëve;

gi) për konstatimet në lidhje me publikimet të pavërteta ndaj palës së interesuar, vlera e tarifës është në masën e 20 000 (njëzet mijë) lekëve;

h) për konstatimet e dorëzimit të pasurisë së paluajtshme, në bazë të kontratës së porosisë, sipërmarrjes apo shitjes, vlera e tarifës është në masën e 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekëve;

i) për konstatimet e mospërmbushjes së detyrimit të takimit të fëmijës me prindin, vlera e tarifës është në masën e 5 000 (pesë mijë) lekëve;

j) për konstatimet në internet dhe rrjete sociale që ndërveprojnë me njëra-tjetrën në platformat e internetit, vlera e tarifës është në masën e 10 000 (dhjetë mijë) lekëve.

k) për konstatimet mbi pajisjet, aparatet elektronike të identifikuar në pronësi të punëdhënësit nga prodhuesi ose mjeteve të tjera

teknologjike që ruhen ose lidhen me sistemin e informacionit profesional të punëdhënësit, vlera e tarifës është në masën e 10 000 (dhjetë mijë) lekëve.

l) për konstatimet lidhur me ndotjet nga zhurmat dhe lloje të ndryshme të ndotjes, vlera e tarifës është në masën e 10 000 (dhjetë mijë) lekëve.

3. Vlera e tarifave të shërbimit për konstatimet e përmendura në shkronjat “b” deri “l”, si më sipër, zbatohen vetëm nëse koha e përdorur nga përmbartuesi nuk e tejkalon 1 (një) orë pune dhe rritet progresivisht në të njëjtën masë për çdo orë shtesë, derisa shërbimi i kërkuar nga pala kërkuuese të përmbushet nga përmbartuesi.

4. Kur konstatimet kryhen në një qytet tjetër, sipas kërkesës së palës së interesuar, tarifës së konstatimit, sipas pikës 2 të këtij kreu, i shtohet edhe vlera e parapaguar e shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit. Vlera e shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit nuk mund të jetë më e ulët, se:

a) 9 000 (nëntë mijë) lekë, për distancën që varion nga 50 km deri në 100 km;

b) 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë, për distancën që varion nga 100 km deri në 150 km;

c) 27 000 (njëzet e shtatë mijë) lekë, për distancën që varion nga 150 km deri në 200 km;

ç) 36 000 (tridhjetë e gjashtë mijë) lekë, për distancën që varion nga 200 km deri në 250 km;

d) 45 000 (dyzet e pesë mijë) lekë, për distancën që varion nga 250 km deri në 300 km;

dh) 54 000 (pesëdhjetë e katër mijë) lekë, për distanca mbi 300 km.

V. Mënyra e pagimit të tarifës së shërbimit të konstatimit

1. Tarifat e përcaktuara në kreun IV të këtij udhëzimi paguhen nga pala e interesuar nëpërmjet sistemit bankar, në llogarinë e përmbartuesit gjyqësor privat për administrimin e aktivitetit tregtar si person fizik ose juridik.

2. Pagesa bëhet në përputhje me parashikimet e kontratës që lidhet midis përmbartuesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar për konstatimin e fakteve, sendeve dhe dukurive lehtësisht të verifikueshme, që nuk kërkojnë njohuri specifike teknike sipas legjislacionit në fuqi të miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

SHTOJCA NR. 1
PROCESVERBALI I KONSTATIMIT

PROCESVERBAL KONSTATIMI

Sot më datë _____, në orën ____:____, vendi _____ (qyteti, adresa) në bazë të kërkesës së datës _____, të bërë nga i interesuari _____, unë përmbaruesi gjyqësor privat _____, i identifikuar licencën me nr. _____, mbaj këtë procesverbal konstatimi sipas kërkesës së palës së interesuar, i cili për shkak të _____ (përshkruhet motivi i kërkesës) kërkoi konstatimin e faktit/dukurisë/sendit _____ (përshkruhet në mënyrë të detajuar fakti/ dukuria/ sendi objekt konstatimi).

Të pranishëm në këtë konstatim janë personat e mëposhtëm:

1. _____
2. _____
3. _____

(Emër, mbiemër, numri personal i identifikimit, si dhe nënshkrimi i tyre. Në rast se i pranishmi nuk pranon të nënshkruajë, ky fakt evidentohet në këtë procesverbal nga përmbaruesi gjyqësor privat)

(Përshkruhet me detaje nga përmbaruesi gjyqësor privat informacioni konstatues, duke pasqyruar të dhëna dhe detaje që fiksohen dhe referojnë veprimet e konstatimit që kryhen nga përmbaruesi, si dhe mjetet e përdorura për bërjen e konstatimit, vendi ku bëhet konstatimi dhe detaje lidhur me transportin deri në vendndodhjen e konstatimit.)

Pjesë e domosdoshme e procesverbalit janë:

1. Kërkesa e të interesuarit e nënshkruar prej tij;
2. Fatura përmbarimore me TVSH që pasqyron tarifën e aplikuar.

Pjesë përbërëse të procesverbalit janë dokumentet që lidhen drejtpërdrejtë me faktin/dukurinë/sendin e konstatuar:

(Përshkruhen me detaje elementet identifikuese dhe të dhënat kryesore të dokumentit që i bashkëlidhen këtij procesverbal.)

PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT

(EMËR MBIEMËR)

(Nënshkrimi dhe vula personale)

Data ____.

**UDHËZIM****Nr. 5, datë 31.3.2023****PËR KAKTIMIN E TARIFAVE TË
VEPRIMTARISË DYTËSORE TË
PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT
PËR KRYERJEN E NJOFTIMIT APO
MBLEDHJES SË DETYRIMEVE
FINANCIARE ME MIRËKUPTIM**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 36, pika 2, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”,

UDHËZOJ:**I. Objekti i udhëzimit**

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i tarifave për kryerjen e njoftimit apo kryerjen e mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim, si veprimtari dytësore e përmbarruesit gjyqësor privat, me kërkesë të të interesuarve, si dhe përcaktimi i mënyrës së pagesës së tyre.

II. Fusha e zbatimit të udhëzimit

1. Ky udhëzim zbatohet në rastet e kryerjes së njoftimit apo mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim, ndërmjet:

- a) personave fizikë;
- b) personave fizikë dhe juridikë privatë;
- c) personave juridikë privatë.

2. Në fushën e zbatimit të këtij udhëzimi nuk përfshihen detyrimet e përcaktuara në aktet noteriale ose vendimet gjyqësore të formës së prerë, për të cilat është lëshuar urdhër ekzekutimi dhe ka filluar procesi i ekzekutimit të detyrueshëm, si dhe vendimet gjyqësore që kanë marrë formë të prerë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 38/2017, datë 30.3.2017, “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, që janë vënë në ekzekutim nga shërbimi përmbarrimor.

III. Llojet e vlerave dhe detyrimeve financiare që i nënshtrohen tarifimit nga shërbimi përmbarrimor gjyqësor privat

1. Ky udhëzim zbatohet për vlerat dhe detyrimet financiare të mëposhtme:

a) detyrime të papërcaktuara me akt shkresor, që pranohen nga palët;

b) detyrime të përcaktuara me akt shkresor, të nënshkruara dhe të pranura nga palët;

c) aktet noteriale apo aktet e tjera të njohura nga ligji, në të cilat përcaktohet detyrimi ndërmjet palëve;

d) aktet e kredive bankare dhe institucioneve financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë, në të cilat shuma e kredisë së përfutur nga kredimarrësi është më e vogël se vlera e pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme, që garanton përmbushjen e shlyerjes së plotë të detyrimit;

2. Në të gjitha rastet e mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim, të përcaktuara në këtë krye, respektohen detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për parandalimin dhe pastrimin e parave.

IV. Tarifa për mbledhjen e detyrimeve financiare me mirëkuptim

1. Tarifa e shërbimit për mbledhjen e detyrimeve financiare me mirëkuptim është pagesa, që kryhet për të mundësuar shërbimin e përmbarruesit, për njoftimin dhe mbledhjen e tyre.

2. Për përcaktimin e tarifave të shërbimit të mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim sipas vlerës së detyrimit do të ketë tri fasha, në të cilat subjektet përmbarrimore do të referojnë, si më poshtë:

a) Për vlera detyrimi deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë, tarifa e shërbimit do të jetë jo më e lartë se 20%;

b) Për vlera detyrimi deri në 90 000 000 (nëntëdhjetë milionë) lekë, tarifa e shërbimit do të jetë jo më e lartë se 10%;

c) Për vlera detyrimi mbi 90 000 000 (nëntëdhjetë milionë) lekë, tarifa e shërbimit do të jetë jo më e lartë se 5%.

3. Tarifës së shërbimit sipas pikës 2 të këtij kreu, i shtohen shpenzimet e procedurës së njoftimit dhe komunikimit ndërmjet palëve për arritjen e marrëveshjes së mirëkuptimit, si më poshtë:

a) shpenzime për njoftimin dhe propozimin e marrëveshjes së mirëkuptimit nga përmbarruesi gjyqësor privat ose dokumentimi i refuzimit të marrëveshjes së mirëkuptimit nga pala, së cilës i drejtohet përmbarruesi gjyqësor, në shumë fikse prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh;

b) shpenzime të realizimit të procesit të komunikimit ndërmjet dy palëve, për arritjen e marrëveshjes së mirëkuptimit, kur pala tjetër pranon njoftimin dhe propozimin e përmbarruesit



gjyqësor privat për mbledhjen e detyrimit me mirëkuptim nga pala e interesuar, në shumën 10 000 (dhjetë mijë) lekë/orë.

4. Në rastet kur palët bien dakord për shitjen e një sendi që ofrohet nga debitori për shlyerjen e detyrimit financiar, shitja e sendit i nënshtrohet procedurës dhe tarifave të zhvillimit të ankandit, në përputhje me udhëzimin e ministrit të Drejtësisë për përcaktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përmbauesit gjyqësor privat për shitjen e sendeve në ankand publik.

5. Tarifa për zhvillimin e ankandit, sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit të Drejtësisë për përcaktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përmbauesit gjyqësor privat për shitjen e sendeve në ankand publik, nuk i shtohet tarifës për mbledhjen e detyrimeve financiare me mirëkuptim, por paguhet nga blerësi i sendit në ankand, me përjashtim të rasteve kur ka marrëveshje të kundërt me shkrim.

V. Mënyra e pagimit të tarifës së shërbimit

1. Tarifa e shërbimit, sipas pikës 2 të kreut IV të këtij udhëzimi, paguhet nga pala e interesuar, dhe/ose nga pala tjetër kur nënshkruhet një marrëveshje për këtë qëllim, ose nga të dyja palët në bazë të marrëveshjes ndërmjet tyre.

2. Tarifat sipas përcaktimeve në kreun IV të këtij udhëzimi, paguhet në llogarinë e përmbauesit gjyqësor privat.

3. Shpenzimet e procedurës së njoftimit dhe të komunikimit ndërmjet palëve parapaguhet në llogarinë e përmbauesit gjyqësor privat, në momentin e kryerjes së secilës fazë të saj.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

UDHËZIM

Nr. 10, datë 31.3.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 27.5.2021, “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL, SI DHE ASPEKTET E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE, PËRBËRJES SË NJËSISË SË ZHVILLIMIT TË OFRUESVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL DHE ZHVILLIMIT TË VAZHDUAR PROFESIONAL TË PERSONELIT”

Në mbështetje të pikës 4, neni 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 12, pika 4, dhe të nenit 15, pika 3, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 14, datë 27.5.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë:

1. Në kreun XVI, neni 68, pas pikës 4, shtohet pika 5 me përmbajtjen si më poshtë:

“5. Përgjegjësi i sektorit të Administrimit në Formimin Profesional

Përgjegjësi i Sektorit të Administrimit të Formimit Profesional përgjigjet për personelin mësimdhënës të formimit teoriko-praktik dhe kryen çdo detyrë që lidhet me funksionin e tij, si më poshtë:

i. Planifikon dhe organizon punën për mbikëqyrjen e zbatimit të procesit mësimor;

ii. Zbaton procesin e vlerësimit të performancës të stafit në varësi;

iii. Planifikon dhe organizon punën me përgjegjësin e sektorit të shërbimeve mbështetëse për shpërndarjen e bazës materiale të nevojshme



për zbatimin e teorisë dhe praktikave profesionale në mjediset e ofruesit të formimit profesional;

iv. Planifikon dhe organizon punën për mbikëqyrjen e realizimit të procesit të praktikave profesionale të kursantëve në biznes;

v. Monitoron procesin e frekuentimit të kursit nga kursantët, si dhe harton evidencat javore dhe mujore të frekuentimit për kurset profesionale;

vi. Planifikon dhe organizon punën për identifikimin dhe referimin e nevojave për zhvillimin e vazhduar profesional dhe kualifikimin e mësimdhënësve teoriko-praktik;

vii. Planifikon dhe organizon punën për monitorimin e zbatimit të kurrikulës për lëndët dhe modulet e teorisë dhe praktikës profesionale, referon çështjet e zbatimit të kurrikulës për lëndët dhe modulet e teorisë dhe praktikës profesionale të drejtori i ofruesit të formimit profesional;

viii. Monitoron gjatë gjithë vitit procesin e hedhjes në amzë të rezultateve të kursantëve;

ix. Planifikon dhe organizon punën për zhvillimin e aktiviteteve që lidhen me proceset e sigurimit të cilësisë së ofruesit të formimit profesional;

x. Raporton rregullisht te drejtori i ofruesit të formimit profesional për zbatimin e procesit të administrimit të formimit profesional;

xi. Administron regjistrat e kurseve në përdorim të përditshëm;

xii. Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga drejtori i ofruesit të formimit profesional, në përputhje me legjislacionin e AFP-së dhe legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës.”

2. Në kreun XVII, neni 69, pika 2, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) të ketë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune në menaxhim në sistemin e AFP-së ose fusha në përputhje me kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;”

3. Në kreun XVII, neni 70, pika 7, shfuqizohet.

4. Në kreun XVII, në nenin 71, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë:

“3. Shpallja përmban kriteret e përgjithshme dhe të posaçme për marrjen në punë të drejtorit të ofruesit publik të AFP-së, dokumentet që duhet të paraqiten dhe afatin e aplikimit, që është jo më pak se 5 ditë pune, në faqen zyrtare të AKPA-së.”

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë:

“4. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankimim, për rezultatin e pikëve pranë ofruesit të AFP-së, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e marrjes së rezultateve të vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të ankesës.”

5. Në kreun XVII, në nenin 75, pas pikës 3, shtohet pika 4, me përmbajtje, si më poshtë:

“4. Zëvendësimi i përkohshëm i drejtorit:

i. Kur drejtori i ofruesit të AFP-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi, nuk e ushtron përkohësisht detyrën e tij, drejtori i përgjithshëm i AKPA-së, propozon zëvendësimin me një nëndrejtor të ofruesit të AFP-së ose një mësues/punonjës, në rastin kur nuk ka nëndrejtor, për drejtimin e përkohshëm të institucionit.

ii. Kur vendi i drejtorit të ofruesit të AFP-së, shpallet i lirë, drejtori i përgjithshëm i AKPA-së, propozon zëvendësimin me një nëndrejtor të ofruesit të AFP-së ose me një mësues/punonjës, në rastin kur nuk ka nëndrejtor, për drejtimin e përkohshëm të institucionit, deri në përfundim të procesit të konkurrimit, sipas afateve të përcaktuara në këtë udhëzimi.”

6. Në kreun XVII, neni 78, pas pikës 7, shtohet pika 8 me përmbajtjen, si më poshtë:

“8. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankimim, për rezultatin e pikëve pranë ofruesit të AFP-së, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e marrjes së rezultateve të vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të ankesës.”

7. Në kreun XVII, neni 84, pika 1, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me përmbajtje, si më poshtë:

“ë) Në rastin kur bie numri i nxënësve të regjistruar, mbi të cilin bazohet përcaktimi i numrit të nëndrejtoreshave në një ofrues publik i arsimit profesional, me qëllim rrvlerësimin e dosjeve të të gjithë nëndrejtoreshave, drejtori i ofruesit të AFP-së ngre komisionin përkatës sipas përcaktimeve të nenit 81 të këtij udhëzimi. Procedura e vlerësimit bëhen sipas përcaktimeve të nenit 82 të këtij udhëzimi.”

8. Në kreun XXI, neni 108, pas pikës 8, shtohet pika 9, me përmbajtjen si më poshtë:

“9. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankimim, për rezultatin e pikëve pranë ofruesit të AFP-së, brenda 3 (tri) ditëve kalendarike nga data e marrjes së rezultateve të vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje



brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e depozitimit të ankesës.”.

9. Në kreun XXI, neni 111, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 1, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“1. c) “një mësimdhënës teoriko-praktik me përvojë të gjatë në ofruesin e AFP-së.”.

b) Pika 2, shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“2. d) vëzhgon dy orë mësimore të aplikantit për mësues, dy seanca instruktimi të aplikantit për instruktor, nëpërmjet të paktën tre anëtarëve të komisionit të vlerësimit dhe çdo anëtar e vlerëson me pikët nga 1 në 10.”.

10. Në kreun XXI, në nenin 115, shtohen pikat 4 dhe 5 me përmbajtjen si më poshtë:

“4. Kur në një nga ofruesit e AFP-së bie numri i ngarkesës mësimore për një profil/lëndë, drejtori i ofruesit të AFP-së krijon komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve të të gjithë mësuesve të atij profili/lënde.

5. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve:

a) Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve përbëhet nga drejtori i ofruesit të AFP-së (kryetar), një mësues i ofruesit të AFP-së që vlerësohet për profesionalizëm dhe korrektësi në profesion (anëtar) dhe kryetari i këshillit të prindërve të ofruesit të AFP-së (anëtar).

b) Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në ofruesin e AFP-së, ka për detyrë të bëjë vetëm vlerësimin e dosjeve të mësuesve të profilit/lëndës, për të cilën bie numri i orëve sipas nenit 112 të këtij udhëzimi, dhe të publikojë në mjediset e institucionit rezultatet me ID-të përkatëse.

c) Mësuesve që rezultojnë pa ngarkesë mësimore dhe mbeten të pasistemuar, si pasojë e mungesës së vendeve të punës, u ndërpritet marrëdhënia e punës, duke u bazuar në procedurat e përcaktuara në Kodin e Punës.”.

11. Në kreun XXIII, neni 122, në pikën 4 togfjalëshi “përgjegjës in e sektorit të menaxhimit financiar dhe aseteve” zëvendësohet me togfjalëshin “përgjegjës in e sektorit financë-administrim”.

12. Në nenin 122, shkronja “a” e pikës 4 ndryshon si më poshtë:

“a) Të ketë diplomë studimi të ciklit të dytë në shkencat ekonomike ose diplomë universitare të ekuivalentuar me të.”.

13. Në nenin 122, në shkronjën “b” të pikës 4, togfjalëshi “përvojë në pozicione të vlefshme” zëvendësohet me togfjalëshin “përvojë në profesion”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

URDHËR

Nr. 241, datë 31.3.2023

PËR MIRATIMIN E MODELIT TË KONTRATËS QË LIDHET MIDIS PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT DHE PALËS SË INTERESUAR PËR SHITJEN E SENDEVE NË ANKAND PUBLIK


Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; si dhe të nenit 14, shkronja “h”, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përbarimor gjyqësor privat”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e modelit të kontratës që lidhet midis përbaruesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar për shitjen e sendeve në ankand publik, sipas tekstit të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Marrëdhëniet kontraktore ndërmjet zyrës së përbarimit privat ose përbaruesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar rregullohen sipas legjislacionit në fuqi dhe përcaktimeve të të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në kontratën e shërbimit.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, zyrat e përbarimit privat, përbaruesit gjyqësorë privatë, si dhe Dhoma Kombëtare e Përbaruesve Gjyqësorë Privatë, për ndjekjen dhe zbatimin këtij urdhri.





aplikimin, në llogarinë e përmbaruesit gjyqësor privat. Përpara publikimit të kërkesës në faqen elektronike të zhvillimit të ankandeve të paguajë tarifën e zhvillimit të procedurës së ankandit.

2. Të vendosë në dispozicion të zyrës së përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat, sipas rastit, dokumentacionin e pronësisë së sendit ose vetëdeklarimin mbi pronësinë e sendit.

3. T'i japë të drejtë zyrës së përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat të kërkojë dhe marrë informacionin që i nevojitet rreth sendit që kërkohet të shitet në ankand me qëllim përmbushjen e objektit të kësaj kontrate.

4. Të mos kryejë asnjë veprim që pengon përmbushjen e objektit të kësaj kontrate, si dhe të kryejë të gjitha veprimet e tjera të nevojshme, me qëllim që të mos cenohet sendi dhe që të mos pengohet shitja e tij në ankand.

5. Të njoftojë zyrën e përmbarimit privat/përmbaruesin gjyqësor privat për çdo cenim të pronësisë së sendit ose të vetë sendit që kërkohet të shitet në ankand menjëherë, por jo më vonë se 24 orë nga marrja dijeni mbi cenimin.

6. Të njoftojë me shkrim zyrën e përmbarimit privat/përmbaruesin gjyqësor privat për heqjen dorë nga shitja e sendit në ankand përpara se zyra e përmbarimit privat/përmbaruesi gjyqësor privat të ketë filluar procedurën e publikimit të ankandit publik.

7. Të sillt në kushtet e mirëbesimit dhe të mbajë marrëdhënie të mira dhe korrekte me zyrën e përmbarimit privat/përmbaruesin gjyqësor privat.

Neni 5

Të drejtat e zyrës së përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat

Zyra e përmbarimit privat/përmbaruesi gjyqësor privat ka të drejtë:

1. Të njihet me kërkesën për shitjen e sendit në ankand dhe të sigurohet nga kërkuesi/pala e interesuar se ky i fundit ka kuptuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

2. Të verifikojë paraprakisht dokumentet e pronësisë së sendit në emër të kërkuesit/palës së interesuar, si dhe të kërkojë e të marrë çdo informacion të nevojshëm mbi sendin, që i

shërben përmbushjes së objektit të kësaj kontrate.

3. Të kërkojë pagimin e tarifave për zhvillimin e procedurave të ankandit.

4. Të mos fillojë apo të ndërpresë zhvillimin e procedurës së ankandit, kur kërkuesi/pala e interesuar nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë për pagimin e tarifave.

Neni 6

Detyrimet e zyrës së përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat

Zyra e përmbarimit privat/përmbaruesi gjyqësor privat merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Të kryejë të gjitha procedurat që lidhen me njoftimin publik të ankandit dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë.

2. Të informojë kërkuesin/palën e interesuar lidhur me veprimtarinë për përmbushjen e objektit të kësaj kontrate, si dhe të mos e pengojë atë që të jetë prezent gjatë zhvillimit të ankandit.

3. Të kthejë dokumentet e pronësisë së sendit që shoqëron kërkesën e palës së interesuar në rastin e zgjidhjes së kontratës ose heqjes dorë nga kërkesa për shitjen e sendit në ankand.

4. Të përsërisë seancën e ankandit për sendin objekt të kësaj kontrate, përcaktuar në nenin 1, jo më shumë se 1 (një) herë nëse ajo ka përfunduar pa ofertues dhe blerës në seancën/ankandin e parë dhe jo më vonë se 1 (një) muaj nga dita e zhvillimit të tij.

5. Pas shitjes së sendit në ankand, të mbajë vlerën e tarifës mbi vlerën e shitjes së sendit në ankand, në përputhje me parashikimet e udhëzimit të ministrit të Drejtësisë “Për caktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përmbaruesit gjyqësor privat për shitjen e sendeve në ankand publik”.

6. Të mos publikojë të dhëna personale të palës së interesuar pa pëlqimin paraprak të saj, si dhe të ruajë konfidencialitetin e informacionit të siguruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.

7. Të sillt në kushtet e mirëbesimit dhe të mbajë marrëdhënie të mira dhe korrekte me kërkuesin/palën e interesuar.



Neni 7

Kryerja e pagesave të shërbimit

1. Pagesa e tarifave të shërbimit kryhet nëpërmjet derdhjes në llogarinë bankare të zyrës së përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat pranë bankës “_____”, me numër llogarie _____ dhe IBAN _____.

2. Kërkuesi/pala e interesuar duhet të vërtetojë kryerjen e pagesës nëpërmjet paraqitjes së mandatpagesës pranë zyrës së përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat.

Neni 8

Moskryerja e pagesave

Në rast se kërkuesi/pala e interesuar nuk kryen pagesën e aplikimit dhe procedurës së publikimit dhe zhvillimit të ankandit, sipas kushteve të kësaj kontrate, zyra e përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën.

Neni 9

Pezullimi i kontratës

1. Zyra e përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat nuk mban përgjegjësi nëse mospërmbaruesi e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate, ka ardhur për arsye të forcës madhore, rastit faktor apo veprimeve nga autoritetet ligjzbatuese shtetërore.

2. Gjatë periudhës së treguar në pikën 1, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë, pezullohen.

Neni 10

Rastet e zgjidhjes së kontratës

1. Kontrata quhet e zgjidhur njëanshmërisht nga kërkuesi/pala e interesuar, kur:

a) për shkak të veprimeve/mosveprimeve të kërkuesit/palës së interesuar sendi dëmtohet rëndë ose zhduket;

b) nuk paraqitet ose refuzon të kryejë veprimet e përcaktuara të ankandit publik;

c) nuk kryen pagesat sipas përcaktimeve të kësaj kontrate dhe udhëzimit të ministrit të Drejtësisë, “Për caktimin e tarifave të

veprimtarisë dytësore të përmbaruesit gjyqësor privat për shitjen e sendeve në ankand publik”;

ç) heq dorë nga kontrata pas publikimit të ankandit, në kundërshtim me përcaktimet e kësaj kontrate.

2. Kontrata quhet e zgjidhur nga zyra e përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat, kur:

a) përmbaruesit i hiqet ose pezullohet licenca e ushtrimit të profesionit;

b) zyra e përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat falimenton.

3. Kontrata quhet e zgjidhur me vullnet dypalësh kur palët bien dakord me akt të shkruar që marrëdhënia të ndërpritet pa asnjë shpërblim.

Neni 11

Pasojat e zgjidhjes së kontratës

Në rastin e zgjidhjes së kontratës:

1. Sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 10, kërkuesi/pala e interesuar mund të tërheqë dokumentacionin që shoqëron kërkesën, por nuk i kthehen pagesat e kryera;

2. Sipas shkronjave “c” dhe “ç”, të pikës 1, të nenit 10, kërkuesi/pala e interesuar mund të tërheqë dokumentacionin, por paguan në këtë rast në llogarinë e përmbaruesit gjyqësor privat një shumë prej 10% të vlerës së sendit që shitet në ankand, bazuar në çmimin minimal për nxjerrjen e sendit në ankand, të përcaktuar në nenin 2 të kësaj kontrate.

3. Sipas pikës 2, të nenit 10, përmbaruesi kthen menjëherë dokumentacionin që shoqëron kërkesën dhe mban përgjegjësi sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 12

Njoftimi midis palëve

1. Me përjashtim të rastit kur palët bien dakord për të zgjidhur një formë tjetër komunikimi dhe njoftimi, çdo njoftim mes palëve sipas kontratës, duhet të bëhet me shkrim në adresën e mëposhtme:

a) Kërkuesi/pala e interesuar _____

Adresa: _____

Adresë e-mail/fax: _____

Numri i tel: _____

Përfaqësuar nga z/znj. _____



b) Zyra e përmbarimit privat/përmbaruesi
gjyqësor privat _____

Adresa: _____

Adresë e-mail/fax: _____

Numri i tel: _____

Përfaqësuar nga z/znj. _____

2. Njoftimi do të ketë efekt, sapo të
konfirmohet dorëzimi nëpërmjet shërbimit
postar apo protokollit.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë
realizimit të kësaj kontrate, zgjidhen me
mirëkuptim mes palëve.

2. Nëse nuk arrihet zgjidhja me mirëkuptim
dhe marrëveshje mes palëve, ato mund t'i
drejtohen gjykatës së rrethit gjyqësor ku zyra e
përmbarimit privat/përmbaruesi gjyqësor privat
ka selinë.

Neni 14

Dokumentacioni bashkëlidhur kontratës

Kësaj kontrate, si pjesë përbërëse e saj, i
bashkëlidhen edhe dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesa e palës së interesuar për shitjen e
sendit në ankand, që i bashkëlidhet kontratës dhe
bëhet pjesë përbërëse e saj;

2. Dokumentin që vërteton pronësinë, nëse
ka;

3. Vetëdeklarim i pronësisë së sendit;

4. Autorizimin për përdorimin e të dhënave
personale;

5. Mandatpagesa që lëshon banka.

Neni 15

Parashikime të fundit

1. Kontrata hartohet në 3 (tri) kopje me të
njëjtën vlerë ligjore, ku njëra mbahet nga
përmbaruesi, njëra në arkivin e zyrës së
përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat
dhe tjetra mbahet nga kërkuuesi/pala e interesuar.
Kopjes origjinale të kontratës që mban
kërkuuesi/pala e interesuar, i bashkëlidhet
fotokopja e akteve të parashikuara në nenin 16 të
kësaj kontrate.

Faqe | 6792

2. Kontrata nënshkruhet në çdo fletë nga të
dyja palët kontraktore.

Neni 16

Efektet, hyrja në fuqi dhe përfundimi

1. Kjo kontratë është e vlefshme për sa është
parashikuar në të, deri në realizimin e objektit të
kontratës.

2. Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë me
nënshkrimin nga palët.

Kjo kontratë, pasi u lexua me zë të lartë dhe
kuptua, u nënshkrua rregullisht nga palët, si më
poshtë:

KËRKUESI/PALA E INTERESUAR

(emër, mbiemër, firmë)

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT/PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT

(vula) (emër mbiemër, firmë)

Vendi: _____

Data e nënshkrimit _____. _____. _____. _____

SHTOJCA NR. 1
MODELI I KËRKESËS

KËRKESË

**Për shitjen e sendit në ankand publik nga
përmbaruesi gjyqësor privat**

Kërkuues: _____

(Për subjektin fizik jepen: emri, atësia,
mbiemri, numri i dokumentit të identifikimit,
adresa, adresa elektronike; ndërsa për personin
juridik jepen: emri, NUIS-i, selia, adresa
elektronike, si dhe emri, atësia, mbiemri dhe
numri i dokumentit të identifikimit të
përfaqësuesit ligjor.)

Objekti i kërkesës: (shpjegimi i kërkesës,
përshkrimi dhe çmimi minimal i sendit që
kërkohet të shitet në ankand publik nga
përmbaruesi gjyqësor privat)



Baza ligjore: Neni 2, pika 2, shkronja “ç” e nenit 2, neni 36, pika 1, shkronja “d”, si dhe pika 2, të nenit 36 të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat” dhe pika _____ e udhëzimit nr. __, datë __.____._____, të ministrit të Drejtësisë “_____”.

Mënyra e njoftimit/komunikimit: _____
(shënohet mënyra e njoftimit dhe komunikimit).

Drejtuar: Zyrës së Përmbartimit Privat/Përmbartuesit Gjyqësor Privat “_____”.

Pjesa përshkuese e kërkesës në të cilën duhet të shprehet në mënyrë të qartë dhe pa asnjë kundërtënie sendi që do të shitet në ankand:

(Përshkruhen të dhëna identifikuese të sendit. Për sendet e paluajtshme, përshkruhen të dhënat sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme që i bashkëngjitet kontratës. Për sendet e tjera të luajtshme që regjistrohen sipas legjislacionit në fuqi përshkruhet të dhënat, sipas dokumenteve që provojnë pronësinë e sendit. Për sendet e luajtshme të përdorimit të zakonshëm dhe që nuk kanë veçanërisht vlerë muzeale, nomizmatike, koleksioni, artistike, pronësia e të cilave nuk mund të vërtetohet ndryshe, përshkruhen në mënyrë të detajuar të dhënat identifikuese të sendit, si dhe bashkëlidhet vetëdeklarimi mbi pronësinë e tij.)

- (Listim dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e kërkuarit mbi sendin, në veçanti kur sendi është i paluajtshëm.)

KËRKUESI
EMRI MBIEMRI
NËNSHKRIMI/DATA

URDHËR

Nr. 242, datë 31.3.2023

PËR MIRATIMIN E MODELIT TË KONTRATËS QË LIDHET MIDIS PËRMBARTUESIT GJYQËSOR PRIVAT DHE PALËS SË INTERESUAR PËR NJOFTIMIN DHE MBLEDHJEN E DETYRIMEVE FINANCIARE ME MIRËKUPTIM

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; si dhe të nenit 14, shkronja “g”, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e modelit të kontratës që lidhet midis përmbartuesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar për njoftimin dhe mbledhjen e detyrimeve financiare me mirëkuptim, sipas tekstit të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Marrëdhëniet kontraktore ndërmjet zyrës së përmbartimit privat ose përmbartuesit gjyqësor privat dhe palës së interesuar rregullohen sipas legjislacionit në fuqi dhe përcaktimeve të të drejtave dhe detyrimeve të parashikuara në kontratën e shërbimit.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, zyrat e përmbartimit privat, përmbartuesit gjyqësorë privatë, si dhe Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, për ndjekjen dhe zbatimin këtij urdhri.

4. Ngarkohet Sektori i Arkiv Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja



SHTOJCA NR. 1
**KONTRATË SHËRBIMI PËR
NJOFTIMIN DHE MBLEDHJEN E
DETYRIMEVE FINANCIARE ME
MIRËKUPTIM**

Sot, më datë _____, në zyrën e përmbartimit privat/përmbartuesit gjyqësor privat “_____” lidhet kjo kontratë shërbimi midis:

A. Zyrës së përmbartimit privat/përmbartuesit gjyqësor privat _____ (me nr. licence _____, NUIS _____, me adresë postare _____; adresë elektronike, _____,

dhe

B. Palës së interesuar/kërkuesit të shërbimit _____

(Për subjektin fizik jepen: emri, atësia, mbiemri, numri i dokumentit të identifikimit, adresa, adresa elektronike; ndërsa për personin juridik jepen: emri, NUIS-i, selia, adresa elektronike, si dhe emri, atësia, mbiemri dhe numri i dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor.)

Baza ligjore

Hartimi dhe zbatimi i kësaj kontrate bazohet në dispozitat e përgjithshme që parashikohen në Kodin Civil për kontratën e porosisë, për aq sa kanë kuptim, si dhe në ligjin nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”.

Palët e mësipërme bien dakord të lidhin midis tyre kontratën si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i kontratës

Kryerja e të gjitha veprimeve të ligjshme për njoftimin dhe mbledhjen e detyrimeve financiare me mirëkuptim, të përshkruara në kërkesën e të interesuarit drejtuar zyrës së përmbartimit privat/përmbartuesit gjyqësor privat, që konsistojnë në mbledhjen e detyrimit ndërmjet

(Përshkruhet shkurtimisht kërkesa e të interesuarit, palët mes të cilët do të mbledhet detyrimi dhe lloji i vlerës dhe detyrimit financiar).

Neni 2

Të drejtat e kërkuesit/palës së interesuar

Kërkuesi/pala e interesuar, ka të drejtë:

1. Të kërkojë informacion nga zyra e përmbartimit privat/përmbartuesi gjyqësor privat nëpërmjet kërkesës me shkrim, lidhur me veprimtarinë për përmbushjen e objektit të kësaj kontrate, si dhe administrimit të dokumenteve që pasqyrojnë atë.

2. Të heqë dorë nga kërkesa për marrjen e shërbimit, përpara se përmbartuesi gjyqësor privat të ketë filluar me kryerjen e njoftimit për mbledhjen e detyrimit.

3. Të kërkojë kthimin e dokumentacionit që ka shoqëruar kërkesën për njoftimin dhe kryerjen e mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim, kur ka hequr dorë nga marrja e shërbimit.

Neni 3

Detyrimet e kërkuesit/palës së interesuar

Kërkuesi/pala e interesuar merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, të paguajë në llogarinë e zyrës së përmbartimit privat/përmbartuesit gjyqësor privat tarifën për shpenzimet për njoftimin dhe propozimin e marrëveshjes së mirëkuptimit sipas parashikimeve të udhëzimit të ministrit të Drejtësisë “Për caktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përmbartuesit gjyqësor privat për kryerjen e njoftimit apo mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim”.

2. Të paguajë tarifën e shërbimit, sipas marrëveshjes me palën e detyruar për shlyerjen e detyrimit, nëse ka një të tillë.

3. Të japë të gjithë informacionin dhe dokumentet që do të kërkohen dhe ndihmojnë përmbartuesin gjyqësor privat për të kryer veprimet për përmbushjen e objektit të kësaj kontrate.



4. Të njoftojë me shkrim zyrën e përmbarimit privat/përmbaruesin gjyqësor privat për heqjen dorë nga veprimet për njoftimin dhe mbledhjen e detyrimeve.

5. Të mos kryejë asnjë veprim që pengon përmbushjen e objektit të kësaj kontrate, si dhe të kryejë të gjitha veprimet e tjera të nevojshme, në rast se i kërkohet nga ana e përmbaruesit gjyqësor privat, për përmbushjen e objektit të kësaj kontrate.

6. Të nënshkruajë procesverbalet që dokumentojnë veprimet e kryera nga ana e përmbaruesit gjyqësor privat, si dhe ka të drejtën e shënimit të pretendimeve ose vërejtjeve lidhur me përmbytjen e procesverbalit.

7. Të sillet në kushtet e mirëbesimit dhe të mbajë marrëdhënie të mira dhe korrekte me përmbaruesin gjyqësor privat.

Neni 4

Të drejtat e zyrës së përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat

Zyra e përmbarimit privat/përmbaruesi gjyqësor privat ka të drejtë:

1. Të verifikojë paraprakisht nëse objekti i kërkesës është në përputhje me fushën e zbatimit dhe llojet e vlerave dhe detyrimeve financiare që i nënshtrohen tarifimit nga shërbimi përmbarimor, sipas udhëzimit të ministrit të Drejtësisë “Për caktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përmbaruesit gjyqësor privat për kryerjen e njoftimit apo mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim”.

2. Të kërkojë parapagimin e shpenzimeve procedurale të njoftimit.

3. Të kërkojë nga kërkuesi/pala e interesuar dhënien e informacionit ose vendosjen në dispozicion të dokumentacionit e plotë që pasqyron ekzistencën e detyrimit.

4. Të mos fillojë apo të ndërpresë menjëherë kryerjen e veprimeve me qëllim mbledhjen e detyrimeve me mirëkuptim, kur kërkuesi/pala e interesuar nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë për pagimin e tarifave.

Neni 5

Detyrimet e zyrës së përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat

Zyra e përmbarimit privat/përmbaruesi gjyqësor privat merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Të kryejë të gjitha veprimet e duhura ligjore për përmbushjen e objektit të kësaj kontrate.

2. Të informojë kërkuesin/palën e interesuar lidhur me veprimtarinë për përmbushjen e objektit të kësaj kontrate.

3. Të kthejë pagesën e tarifës së shërbimit, në rast se zyra e përmbarimit privat/përmbaruesi gjyqësor privat zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën e shërbimit.

4. Të kthejë dokumentacionin e plotë që shoqëron kërkesën e palës së interesuar, në rastin e zgjidhjes së kontratës ose heqjes dorë nga kërkesa për marrjen e shërbimit.

5. Të mos publikojë të dhënat e palëve midis të cilëve ekziston detyrimi financiar, pa pëlqimin paraprak të tyre, si dhe të ruajë konfidencialitetin e informacionit të siguruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.

6. Të pasqyrojë me korrektësi realitetin në hartimin e procesverbaleve dokumentuese të veprimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke pasqyruar në to edhe pretendimet ose vërejtjet eventuale të palës së interesuar ose të të pranishmëve.

7. Të sillet në kushtet e mirëbesimit dhe të mbajë marrëdhënie të mira dhe korrekte me kërkuesin/palën e interesuar.

Neni 6

Kryerja e pagesave të shërbimit

1. Pagesa e tarifës së shërbimit kryhet nëpërmjet derdhjes në llogarinë bankare të zyrës së përmbarimit privat/përmbaruesit gjyqësor privat pranë bankës “_____”, me numër llogarie _____ dhe IBAN_____.

2. Vlera e tarifës së shërbimit, përlllogaritur sipas shkronjës “_____”, të pikës 2, të kreut IV, të udhëzimit të ministrit të Drejtësisë, “Për caktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përmbaruesit gjyqësor privat për kryerjen e



njoftimit apo mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim”, është në masën _____ lekë.

3. Vlera e tarifës shpenzimeve të procedurës së njoftimit që paguhet në momentin e dorëzimit të kërkesës është në masën _____ lekë dhe paguhet nga kërkuesi/pala e interesuar në momentin e nënshkrimit të kontratës së shërbimit.

4. Kërkuesi/pala e interesuar duhet të vërtetojë kryerjen e pagesës nëpërmjet paraqitjes së mandatpagesës pranë zyrës së përbarimit privat/përbaruesit gjyqësor privat.

Neni 7

Moskryerja e pagesave të shërbimit dhe/ose shpenzimeve

1. Në rast se kërkuesi/pala e interesuar nuk kryen pagesën, sipas kësaj kontrate dhe sipas udhëzimit të ministrit të Drejtësisë “Për caktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përbaruesit gjyqësor privat për kryerjen e njoftimit apo mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim”, zyra e përbarimit privat/përbaruesi gjyqësor privat zgjidh menjëherë dhe në mënyrë të njëanshme kontratën.

Neni 8

Pezullimi i kontratës

1. Zyra e përbarimit privat/përbaruesi gjyqësor privat nuk mban përgjegjësi nëse mospërbushja e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate, ka ardhur për arsye të forcës madhore, rastit fator, apo veprimeve nga autoritetet ligjzbatuese shtetërore.

2. Gjatë periudhës së forcës madhore apo rastit fator, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë, pezullohen.

Neni 9

Rastet e zgjidhjes së kontratës

1. Kontrata quhet e zgjidhur njëanshmërisht nga kërkuesi/pala e interesuar, kur:

a) mungon interesi i ligjshëm i kërkuetit/palës së interesuar për të kërkuar dhe/ose arritur një marrëveshje mirëkuptimi me palë të tjetra;

b) nuk paraqitet ose refuzon të kryejë veprimet e përcaktuara;

c) nuk paguan tarifat sipas kësaj kontrate dhe udhëzimit të ministrit të Drejtësisë “Për caktimin e tarifave të veprimtarisë dytësore të përbaruesit gjyqësor privat për kryerjen e njoftimit apo mbledhjes së detyrimeve financiare me mirëkuptim”;

ç) heq dorë nga kontrata pas kryerjes së njoftimit palës tjetër.

2. Kontrata quhet e zgjidhur njëanshmërisht nga përbaruesi gjyqësor privat, kur:

a) përbaruesi gjyqësor privat e ka të pamundur të kryejë detyrën dhe shërbimin e nisur për arsye shëndetësore për një periudhë më shumë se 30 ditë pa ndërprerje;

b) përbaruesi gjyqësor privat, për arsye studimore, e ka të pamundur të kryejë detyrën e tij për një periudhë mungese më shumë se 30 ditë pa ndërprerje;

c) përbaruesit i hiqet ose pezullohet licenca e ushtrimit të profesionit;

ç) në rast të falimentimit të zyrës së përbarimit privat/përbaruesit gjyqësor privat.

3. Kontrata quhet e zgjidhur me vullnet dypalësh kur palët bien dakord me akt të shkruar që marrëdhënia të ndërpritet pa asnjë shpërblim.

Neni 10

Pasojat e zgjidhjes së kontratës

Në rastin e zgjidhjes së kontratës:

a) sipas pikës 1, të nenit 9, kërkuesi/pala e interesuar mund të tërheqë dokumentacionin që shoqëron kërkesën por nuk i kthehen pagesat e kryera;

b) sipas pikës 2, përbaruesi kthen menjëherë dokumentacionin që shoqëron kërkesën dhe mban përgjegjësi sipas legjislacionit përkatës në fuqi;

Neni 11


Njoftimi midis palëve

1. Me përjashtim të rastit kur palët bien dakord për të zgjedhur një formë tjetër komunikimi dhe njoftimi, çdo njoftim mes palëve sipas kontratës, duhet të bëhet me shkrim në adresën e mëposhtme:

a) Kërkuesi/pala e interesuar _____

Adresa: _____

Adresë e-mail/fax: _____



*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë